



Qeveria e Kosovës
Vlada Kosova - Government of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Zyra për Qeverisje të Mirë / Kancelarija za Dobro Upravljanje / Office on Good Governance



RAPORT VJETOR PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR ORGANIZATAT JO-QEVERITARE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS PËR VITIN 2021

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTESAVE	3
1. HYRJE	5
1.1 Metodologjia e përdorur	7
2. TË DHËNA E PËRGJITHSHME PËR RAPORTIM NGA ANA E ORGANIZATAVE BUXHETORE	9
2.1 . Raportimi nga Organizatat Buxhetore.....	9
2.2 Të dhëna mbi raportimin sipas secilës nga Organizatat Buxhetore.....	12
3. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR OJQ-TË NË NIVEL TË MINISTRIVE, KOMUNAVE DHE AGJENCIVE TJERA TË PAVARURA	16
4. TË DHËNA PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR OJQ-TË SIPAS MINISTRIVE, KOMUNAVE DHE AGJENCIVE TJERA	22
4.1 Të dhënat e përgjithshme për Financimin Publik të OJQ-ve për vitin 2021 sipas raportimit nga Institucionet Publike/Organizatave buxhetore	22
4.2 Mbështetja Financiare për OJQ-të në kuadër të MINISTRIVE për vitin 2021.....	24
4.2.1 Numri i projekteve dhe shumat e mbështetjes financiare për OJQ-të përfituese nga përkrahja finaciare e Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.....	27
4.2.3 Analizë e thirrjeve publike në nivel të Ministrive	31
4.3 Mbështetja në kuadër të KOMUNAVE	33
4.3.2 Analizë e Thirrjeve Publike në nivel të Komunave	34
4.3.3 Numri i OJQ-ve përfituese nga Financimi i komunave dhe ndarja sipas shumave të mbështetjes financiare	35
4.4 Mbështetja financiare publike nga Agjencitë e pavarura dhe institucionet tjera publike	38
5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	40
6. ANEKSE: LISTA E PËRFITUESVE SIPAS INSTITUCIONEVE DHE SHUMA E MBËSHTETJES FINANCIARE PUBLIKE PËR VITIN 2021	43
6.1 LISTA E OJQ-VE PËRFITUESE NGA MBËSHTETJA FINANCIARE PUBLIKE NË KUADËR TË MINISTRIVE TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2021.....	43
6.2 LISTA E OJQ-VE PËRFITUESE NGA MBËSHTETJA FINANCIARE PUBLIKE NË KUADËR TË KOMUNAVE TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2021	78
6.3 LISTA E OJQ-VE PËRFITUESE NGA MBËSHTETJA FINANCIARE PUBLIKE NË KUADËR TË AGJENCIVE DHE ORGANIZATAVE TJERA BUXHETORE PËR VITIN 2021	133

LISTA E SHKURTESAVE

MPB	MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
MAPL	MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
MASHTI	MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
MBPZHR	MINISTRIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MD	MINISTRIA E DREJTËSISË
MFPT	MINISTRIA E FINANCIVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE
MM	MINISTRIA E MBROJTJES
ME	MINISTRIA E EKONOMISË
MKK	MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM
MKRS	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT
MMPH	MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MPJD	MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME DHE DIASPORËS
MSH	MINISTRIA E SHËNDETËSISË
MINT	MINISTRIA E INDUSTRIËS NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË
MZHR	MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL
OJQ	ORGANIZATA JO-QEVERITARE
SHSKUK	SHËRBI MI SPITALOR KLIKIK UNIVERZITAR I KOSOVËS
UP	UNIVERSITETI I PRISHTINËS
ZKA	ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
ZKM	ZYRA E KRYEMINISTRIT
ZP	ZYRA E PRESIDENTIT

Fjalë hyrëse

Të nderuar/a

Po vazhdojmë edhe këtë vit me një praktikë të suksesshme të publikimit të raportit vjetor për mbështetjen financiare publike për organizatat jo qeveritare në Republikën e Kosovës. Pa dyshim, ky është sukses i përbashkët i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe i shoqërisë civile në Kosovë. Krahas publikimit të këtij Raporti, lansimi por edhe avancimi i platformës online të financimit publik të OJQ-ve, ku janë të përfshira të gjitha të dhënat e financimit publik për OJQ-të që nga viti 2015-16, përbënë një sukses të veçantë dhe është një hap para drejt rritjes së transparencës së institucioneve publike në këtë fushë.

Edhe vitin 2021 e vlerësojmë si vit të suksesshëm në bashkëpunimin e institucioneve të Republikës së Kosovës me organizatat e shoqërisë civile. Ky bashkëpunim ka vazhduar të jetë në funksion të implementimit të prioriteteve të të dy sektorëve, por edhe të realizimit të objektivave qeveritare për transparencë, llogaridhënie dhe përgjegjësi të përcaktuara me Rregulloren MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve. Baza e këtij bashkëpunimi është vendosur edhe në Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023.

Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit ka dhënë dhe vazhdon të jap një kontribut të vazhdueshëm në avancimin e transparencës dhe llogaridhënies në ofrimin e mbështetjes financiare publike për OJQ-të edhe gjatë vitit 2021. Kontributi i Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit duhet parë edhe përtej këtij raporti, në veçanti në ofrimin e mbështetjes për zyrtarët publik si dhe për OJQ-të, përmes trajnimeve dhe ngritjes së kapaciteteve të institucioneve publike me qëllim të implementimit sa më të mirë të rregullores MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Ky raport mundëson të kuptojmë progresin që ka arritur Kosova në fushën e financimit publik të OJQ-ve, por edhe të bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile, dhe në të njëjtën kohë, evidenton edhe sfidat të cilat duhet të adresohen në të ardhmen, në mënyrë që kjo fushë të avancojë më tej. Ky raport ofron një serë rekomandimesh të cilat Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave do të përkushtohen që bashkërisht me institucionet publike ti realizojë në praktikë.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, inkurajon të gjitha institucionet publike që të forcojnë mekanizmat e tyre me qëllim të implementimit të kërkesave të legjislacionit në fuqi që ka të bëjë me financimin publik të OJQ-ve. Kjo do të mundësojë rritjen e besimit në institucionet publike dhe krijim të partneritetit me organizatat e shoqërisë civile. Zbatimi i procedurave, kriterëve dhe standardeve për transparencë, llogaridhënie dhe konkurrencë do të mundësojnë që objektivat e financimit publik për OJQ-të të arrihen.

Sinqerisht,

Habit Hajredini, Drejtor, Zyra për Qeverisje të Mirë – Zyra e Kryeministrit

1. HYRJJE

Qeveria e Republikës së Kosovës me qëllim të zbatimit të rregullave dhe procedurave të financimit Publik të Organizatave Joqeveritare që i përcakton Rregullorja e MF. Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, përmes Zyrës për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit, bashkë me ministritë e linjës dhe komunat e Republikës së Kosovës ka vazhduar me publikimin, mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të financimit Publik të OJQ-ve.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit bashkë me Ministrinë e Financave, me bazë të Rregullorja MF-Nr.04/2017 Kosova ka ndërtuar një sistem me rregulla unike sa i përket financimit publik të OJQ-ve, rregulla këto të cilat përcaktojnë kriteret minimale të ndërlidhura me financimin publik të OJQ-ve. Rregullorja MF-Nr. 04/2017 krahas obligimeve tjera përcakton në mënyrë të detajuar përgjegjësinë që institucionet publike kanë për raportimin lidhur me financimin publik të OJQ-ve. Rregullorja synon unifikimin e procedurave për gjithë ciklin e financimit publik të OJQ-ve, duke përfshirë, planifikimin, thirrjet publike, kontraktimin, monitorimin dhe raportimin e këtij finacimi.

Raporti mbi mbështetjen financiare publike për OJQ-të për vitin 2021, përfshinë informacione mbi mbështetjen financiare publike për OJQ-të, ofruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ministritë dhe Komunat për përkrahjen e projekteve të Organizatave Jo-Qeveritare në fusha të ndryshme, të ndërlidhura me prioritet e Institucioneve të Republikës së Kosovës dhe shoqërisë kosovare. Raporti mbulon të gjitha organizatat buxhetore të nivelit qendror dhe lokal të cilat në çfarëdo forme kanë ofruar mbështetje financiare për organizatat jo qeveritare.

Procesi i raportimit për financimin e OJQ-ve është avancuar në vazhdimësi, pra jo vetëm duke e krijuar dhe lansuar platformën për financim, por duke e mundësuar edhe raportimin direkt në platformën për financim publik të OJQ-ve <http://ojqfinancime.rks-gov.net>

Gjatë kësaj kohe kemi punuar në avancim të platformës, ku me një kërkim të lehtë në platformën online mund të gjinden të dhënat për mbështetjen financiare publike për OShC-të sipas viteve, institucioneve, OJQ-ve, regjione, fushave etj. Për herë të parë këtë vit do ta realizojmë transparencën e plotë të shpenzimeve të buxhetit për sektorin e shoqërisë civile duke ofruar të gjitha të dhënat e procesit të shpenzimit të parasë publike për OJQ-të. Është punuar dhe arritur që raporti për vitin 2021 të përgatitet dhe publikohet direkt në platformë, pra të gjitha organizatat buxhetore do të raportojnë drejtpërdrejtë përmes platformës, duke ngarkuar të dhënat mbi financimin publik të OJQ-ve që i kanë përkrahur.

Ky proces është avancuar në vazhdimësi, pra ndërsa që nga viti 2020 është krijuar dhe lansuar platforma <http://ojqfinancime.rks-gov.net> e cila siguron transparencë edhe më të madhe në shpenzimin e parasë publike për projektet dhe programet e OJQ-ve, në vitin 2021, platforma është avancuar dhe do të mundësoj që të gjitha organizatat buxhetore të raportojnë drejtpërdrejtë përmes saj, duke ngarkuar të dhënat mbi financimin publik të OJQ-ve për vitin paraprak. Kjo do të mundësoj

që të rritet transparenca në financimin e projekteve të OJQ-ve, duke publikuar më shumë të dhëna për projektet e financuara nga ana e autoriteteve publike. Ky proces kërkon angazhim të shtuar për Organizatat buxhetore, dhe në të njëjtën kohë një koordinim më të mirë brenda vetë organizatës Buxhetore dhe Zyrës për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit, në përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga Rregullorja MF. Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Publikimi i raportit gjithëpërfshirës për mbështetjen financiare publike për OJQ-të në Republikën e Kosovës për vitin 2021 është bërë një praktikë e vazhdueshme e Qeverisë së Republikës së Kosovës në vitet e fundit. Ky raport ka për qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënie së institucioneve publike, duke mundësuar po ashtu në krijimin e besimit të ndërsjellë në mes të institucioneve publike dhe shoqërisë civile. Prandaj, publikimi i vazhdueshëm i raporteve vjetore për mbështetjen financiare publike për OJQ-të ka dhënë efektet e veta pozitive në përmirësimin e zbatueshmerisë së rregullativës ligjore që mbulon fushën e financimit publik të OJQ-ve në Republikën e Kosovës.

Që nga raporti i parë i vitit, kur mungonin rregullat sa i përket kriterëve, standardeve dhe procedurave të financimit publik të OJQ-ve e deri në vitin 2021, vërehet një përmirësim shumë i madhe cilësor si në aspektin e vendosjes së kornizës ligjore, e po ashtu edhe në zbatimin e saj në praktikë. Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit në vazhdimësi është duke punuar me institucionet publike, për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe për të zbatuar në mënyrën e duhur, kornizën ligjore që rregullon këtë fushë. Publikimi i Raporteve Vjetore të mbështetjes financiare publike për OJQ-të ka marrë vlerësime pozitive nga të gjitha institucionet, shoqëria civile por edhe nga Raporti i Komisionit Evropian, duke e konsideruar si një hap pozitiv drejt një transparence më të madhe të financimit publik të OJQ-ve. Tashmë vërehet një praktikë e mirë e krijuar në të gjitha organizatat buxhetore për të hapur thirrje publike për financimin e projekteve të OJQ-ve. Mund të vërehet një avancim në aplikimin dhe zbatimin e rregullores sa i përket financimit publik të OJQ-ve. Institucionet kanë publikuar thirrjet publike në web faqet e tyre në shumicën e rasteve, dhe të njëjtat janë të qasshme online. Megjithatë, ende vërehen raste të ofrimit të mbështetjes financiare publike direkte. Gjithashtu, ndonëse rregullorja është e qartë në kërkesat e saja, disa nga organizatat buxhetore edhe pse kanë publikuar thirrje publike, të njëjtat nuk kanë qenë plotësisht në linjë me kërkesat e rregullores, ose nuk kanë qenë mjaft të qarta dhe të ndërlidhura me prioritetet e institucioneve të definuara në dokumentet strategjike.

Sa i përket raportimit dhe publikimit të informatave lidhur me financimin publik të OJQ-ve për vitin 2021 nga ana e Organizatave Buxhetore, ende ka mjaft hapësirë për përmirësim të gjendjes, sepse edhe në kohën kur ky raport gjithëpërfshirës është përgatitur, disa organizata buxhetore ende nuk i kanë publikuar raportet mbi financimin publik të OJQ-ve për vitin 2021 e as nuk i kanë dërguar te Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në përputhje me kërkesat e Rregullores.

Si rrjedhojë edhe këtë vit, Zyra për Qeverisje të Mirë, me qëllim të informimit sa më të mirë të publikut lidhur me mbështetjen financiare publike për Organizatat jo Qeveritare, edhe këtë vit ka bashkëpunuar me Ministrinë e Financave, gjegjësisht me Thesarin. Kjo është bërë në mënyrë që të

përgatitet një raport sa më gjithëpërfshirës bazuar në pagesat që organizatat buxhetore kanë ekzekutuar për përfituesit të cilët janë regjistruar në Thesar si Organizata Jo-Qeveritare. Po ashtu, në aneks janë paraqitur të dhënat e raportuara nga ana e Organizatave Buxhetore, pra të dhënat sipas kërkesës së Rregullores për ato organizata që kanë përmbushur detyrimin Ligjor për Raportim. Publikimi i këtij raporti vlerësojmë se do ti kontribuojë rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike dhe në të njëjtën kohë do të ketë ndikim në përmirësimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile në Republikën e Kosovës.

Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit ka punuar me shumë Institucione Qeveritare/Organizata Buxhetore për të forcuar kapacitetet e tyre në implementimin e kërkesave të kësaj rregulloreje.

Shfrytëzojmë rastin që në emër të Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit të falënderojmë të gjitha institucionet publike për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe në të njëjtën kohë kërkojmë përkushtimin dhe bashkëpunimin të tyre edhe më të madh në të ardhmen!

1.1 Metodologjia e përdorur

Zyra e Kryeministrit /Zyra për Qeverisje të Mirë dhe Ministria e Financave tashmë kanë krijuar një sistem transparent dhe të përgjegjshëm për financimin e Organizatave të Shoqërisë Civile. Zyra e Kryeministrit /Zyra për Qeverisje të Mirë, transparencën dhe përgjegjshmërinë për ndarjen e fondeve publike për OShC-të e ka forcuar edhe më shumë me krijimin por edhe me përditësimin dhe avancimin e Platformës Online për Financim Publik të OJQ-ve <http://ojqfinancime.rks-gov.net/>.

Kjo patjetër që po kontribuon në rritjen e besimit të publikut në institucionet publike dhe partneritetin me organizatat e shoqërisë civile. Gjithashtu kjo besojmë se do të frymëzoj qytetarët që të bëhen edhe më aktiv dhe të kontribuojnë në dobi të komunitetit. Edhe në këtë kohë të raportimit ashtu si edhe e kemi cekur më lart kemi punuar në avancim të platformës, ku me një kërkim të lehtë në platformën online mund të gjinden të dhënat për mbështetjen financiare publike për OShC-të sipas viteve, institucioneve, OJQ-ve, etj. Për herë të parë këtë vit do ta realizojmë transparencën e plotë të shpenzimeve të buxhetit për sektorin e shoqërisë civile duke ofruar të gjitha të dhënat e procesit të shpenzimit të parasë publike për OJQ-të.

Gjithashtu Kuvendi i Republikës së Kosovës ka nxjerrë rekomandimet të cilat ne si institucione duhet të i zbatojmë në linjë të Rregullores MF-Nr. 4/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat për Financimin Publik të OJQ-ve dhe legjislacionit në fuqi. Rekomandimet e Kuvendit janë miratuar në seancën plenare të mbajtur me 04 tetor 2021, pasi Kuvendi i ka shqyrtuar rekomandimet e dala nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike në lidhje me raportin e auditimit të performancës “Transparenca dhe llogaridhënia në procesin e financimit të organizatave jo-qeveritare” për disa institucione”.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në përputhje me kërkesat e Rregullores, MF-Nr. 04/2017, dhe rekomandimet e Kuvendit ka iniciuar themelimin e një mekanizmi të përhershëm i cili do

të koordinoj punën e planifikimit dhe raportimit vjetor për financimin e organizatave jo-qeveritare në kuadër të secilës ministri dhe komunë. Më 17.08.2021, Zyra e Kryeministrit ka kërkuar nga të gjitha Organizatat Buxhetore që të caktojnë pika kontakti/koordinator të cilët do të jenë përgjegjës për koordinimin e procesit të raportimit të mbështetjes financiare publike për OJQ-të. Në linjë me këtë nismë tashmë është krijuar mekanizmi për Raportimin e mbështetjes së financimit publik për OJQ-të për zbatim të Rregullores MF-Nr. 4/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat për Financimin Publik të OJQ-ve, bazuar edhe në rekomandimet e Kuvendi të Republikës së Kosovës të miratuar me 04 tetor 2021.

Zyrtarët përgjegjës për këtë proces janë caktuar nga 14 ministri, 3 nga Zyra e Kryeministrit, si dhe 30 komunat përgjegjëse. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit menjëherë ka filluar me koordinimin e punës së këtij mekanizmi si dhe në ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të caktuar në përputhje me rregulloren. Bashkë me projektin TACSO dhe ekspertë e angazhuar nga projekti me 09 dhe 10 dhjetor 2021 kemi realizuar sesione informuese për zyrtarët të nivelit qendror e lokal për planifikimin dhe raportimin e financimit publik për OSHC-të. Aktiviteti dyditor shërbeu për të informuar koordinatorët e emëruar mbi detyrat e tyre si dhe për procedurën e decentralizuar të raportimit. Trajnimi përbëhej nga a) Përshkrimi i detyrimeve të koordinatorëve për zbatimin e Rregullores dhe b) Prezantimi i Platformës për financimin publik të organizatave joqeveritare.

Këto pika kontakti janë caktuar me qëllim të koordinimit më të mirë të procesit të përgatitjes së Planit Vjetor të Financimit Publik të OJQ-ve dhe të Raportimit brenda vetë organizatave buxhetore dhe me Zyrën e Kryeministrit. Kjo synon përmbushjen e detyrimeve të Organizatave Buxhetore sipas kërkesave të Rregullores MF. Nr. 04/2017. Obligimet kryesore të Organizatave Buxhetore në drejtim të përgatitjes së Planit Vjetor për Financimin Publik të OJQ-ve dhe përgatitjes së Raportit Vjetor për financimin publik të OJQ-ve rrjedhin nga Rregullorja MF. Nr. 04/2017. Dispozitat e Rregullores përcaktojnë qartë obligimet ndaj komunave dhe ministrive për këto çështje, duke përfshirë edhe afatet kohore për përgatitjen e planit vjetor dhe raportit vjetor. Rregullorja parasheh obligimet e të gjitha organizatave buxhetore për planifikimin dhe raportimin vjetor lidhur me fondet publike të alokuara për organizatat joqeveritare në Kosovë.

Platforma e Financimit Publik iu nënshtrua një përmirësimi për të mundësuar raportimin hierarkik me shumë përdorues për financimin publik të OSHC-ve nga të gjitha Ministrinë/Agjencitë/Komunat e Kosovës dhe nën njësite e tyre përkatëse. Platforma e Financimit Publik tani lehtëson raportimin e financimit publik me futjen e dyfishtë të të dhënave, p.sh. përmes raportimit të drejtpërdrejtë në platformën e secilit prej projekteve të financuara nga institucionet publike, ose raportimit masiv duke u mundësuar organeve publike të mbledhin të dhëna nga të gjitha nën njësite dhe të importojnë të dhënat përmes modulit të importit të platformës. Në anën e qasjes nga publiku të platformës, ka veçori të reja të filtrimit të të dhënave, si dhe grafikët ndërveprues që vizualizojnë të dhënat dhe ndihmojnë publikun të ketë një perceptim se si shpenzohen paratë publike nga secili prej institucioneve, përfituesit e OSHC-ve, territoret ku janë shpenzuar para dhe fushat dhe aktivitetet e përgjithshme të projekteve. Zbatimi i plotë i ndryshimeve dhe reformave në platformë po provohet të arrihet gjatë vitit 2022. E gjithë kjo është pjesë e përpjekjeve më të mëdha të Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit dhe përkrahjes nga TACSO-3, për të lehtësuar bashkëpunimin e OSHC-ve dhe Qeverisë në Kosovë.

Të arriturat dhe sfidat e bashkëpunimit qeveri –shoqëri civile janë identifikuar e vlerësuar edhe te raporti i progresit (raporti për vendin) i këtij viti. Sipas raportit për vendin në përgjithësi, shoqëria civile vazhdon të funksionojë në një mjedis të favorshëm. Mirëpo shoqëria civile dhe qeveria duhet të vazhdojnë të përmirësojnë më tej bashkëpunimin ndërmjet tyre dhe të rrisin aftësinë e shoqërisë civile për të kontribuar në mënyrë kuptimplotë në zhvillimin e politikave publike. Edhe më tej nevojiten përpjekjet për të rritur transparencën e financimit publik për organizatat e shoqërisë civile (OShC-të). Po sipas këtij raporti edhe gjatë pandemisë, shoqëria civile në Kosovë ka vazhduar të luajë një rol të rëndësishëm, veçanërisht në nivelin lokal. Organizatat e shoqërisë civile vazhdojnë të mbështesin drejtpërdrejt zhvillimin dhe zbatimin e reformave të ndërlidhura me BE-në.

Financimi publik për shoqërinë civile vazhdon të raportohet çdo vit dhe të bëhet i qasshëm për publikun. Informatat bazë rreth autoriteteve financuese, organeve përfituese dhe shumës së fondeve të ndara duhet të plotësohen me të dhëna për projektet dhe sektorët. Gjithashtu ajo që vlen të përmendet në këtë fazë të raportimit është se në fillim të vitit 2022 tashmë është iniciuar një rishikim i rregullores aktuale të financimit publik të OJQ-ve, për të adresuar pengesat kryesore të identifikuara gjatë viteve të para të zbatimit të saj.

Pasë parasysh që një numër i organizatave buxhetore nuk kanë arritur të dërgojnë raportet e tyre në përputhje me kërkesat e Rregullores, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit krahas të dhënave të përcjella prej organizatave që kanë raportuar, ne kemi përdorur si të dhëna plotësuese dhe krahasuese edhe bazën e të dhënave të ofruara nga Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Financave. Prandaj, raporti për mbështetjen financiare publike për OJQ-të në kuadër të institucioneve të Republikës e Kosovës për vitin 2021, është përgatitur mbi bazën e të dhënave të siguruara nga organizatat buxhetore dhe Ministria e Financave. Të dhënat e siguruara nga Thesari përfshijnë të gjitha pagesat që janë ekzekutuar brenda periudhës 1 janar - 31 dhjetor të vitit përkatës për furnitorët e regjistruar në Thesar si Organizata Jo-Qeveritare.

Përveç kësaj, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit ka analizuar edhe web faqet e institucioneve publike, për të analizuar thirrjet publike, përmbajtjen e tyre dhe rrjedhën e procesit të një thirrje publike për financimin e OJQ-ve. Janë analizuar në mënyrë të veçantë të dhënat nga Institucionet që kanë raportuar dhe janë paraqitur në aneksin I të këtij raporti. Në pjesën e dytë të raportit është punuar me të dhënat nga Thesari, për të mundësuar një paraqitje gjithëpërfshirëse dhe krahasuese me vitet paraprake.

Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit nuk mbanë përgjegjësi për saktësinë e raportimeve direkte dhe shënimeve përkitazi me emërtimet e OJQ-ve, apo faktin nëse emrat e tyre janë të regjistruara si të tilla në Thesar.

2. TË DHËNA E PËRGJITHSHME PËR RAPORTIM NGA ANA E ORGANIZATAVE BUXHETORE

2.1 . Raportimi nga Organizatat Buxhetore

Rregullorja MF-Nr.04/2017 Kosova ka ndërtuar një sistem me rregulla unike sa i përket financimit publik të OJQ-ve, rregulla këto të cilat përcaktojnë kriteret minimale të ndërlidhura me financimin

publik. Rregullorja MF-Nr. 04/2017 krahas obligimeve tjera përcakton në mënyrë të detajuar përgjegjësinë që institucionet publike kanë për raportimin lidhur me financimin publik të OJQ-ve.

Rregullorja ka përcaktuar po ashtu rolin e Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit në procesin e përgatitjes së Raportit gjithëpërfshirës të mbështetjes financiare publike për OJQ-të, i cili përgatitet mbi bazën e raporteve të të gjitha institucioneve publike. Prandaj, forma e monitorimit dhe raportimit për mbështetjen financiare publike për OJQ-të sipas kësaj rregulloreje është shumë mirë e strukturuar duke përfshirë edhe të dhënat që duhet të përmbaj raportin vjetor. Bazuar në Nenin 26 të rregullores, të gjitha organizatat buxhetore duhet ta përgatisin raportin e tyre më së largu më 1 mars për vitin paraprak fiskal.

Përveç dërgimit të këtij raporti në Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyrën e Kryeministrit, Organizatat buxhetore duhet të njëjtin raport ta publikojnë në faqen e internetit të institucionit përkatës. Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë është përgjegjëse të përmbledhë dhe të publikoj raportin gjithëpërfshirës të mbështetjes financiare Publike për OJQ-të i cili duhet të përfshijë çdo lloj mbështetje financiare që u është dhënë OJQ-ve gjatë vitit paraprak në të gjitha njësitë organizative të organizatave buxhetore në Republikën e Kosovës.

Rregullorja MF. Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, prej që është aprovuar nga Ministria e Financave, ka synuar unifikimin e procedurave për të gjithë ciklin e financimit publik të OJQ-ve. Ky proces është avancuar në vazhdimësi, pra jo vetëm duke krijuar dhe lansuar platformën për financim, por duke e mundur edhe raportimin direkt në platformën për financim publik të OJQ-ve <http://ojqfinancime.rks-gov.net/>. Pra, në vitin 2021 është punuar që në fillim të vitit 2022 platforma të mundësoj që të gjitha organizatat buxhetore të raportojnë drejtpërdrejtë përmes saj, duke ngarkuar të dhënat mbi financimin publik të OJQ-ve për vitin paraprak, pra për vitin 2021. Raportimi është bërë sipas Manualit të cilin ka punuar Zyra për Qeverisje të Mirë/ Zyra e Kryeministrit/ me përkrahjen e ekspertëve të TACSO-s dhe në formatin e përcaktuar me rregullore. Mbi bazën e të gjitha raporteve të institucioneve publike, Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, ka përgatitur raportin gjithëpërfshirës të mbështetjes financiare Publike për OJQ-të në Republikën e Kosovës sipas Nenit 26 të Rregullores MF-Nr. 04/2017.

Manuali i përgaditur ka shpjeguar dhe sqaruar mundësitë dhe hapat në detaje se si ta përdorim platformën për të raportuar për përkrahjen financiare për OSHC-të direkt në platformën <http://ojqfinancime.rks-gov.net/>. Gjithashtu në mënyrë që ta lehtësojmë punën e pikave të kontaktit për raportim ne i kemi përgaditur edhe videot përkrahëse ku janë përshkruar identifikimi dhe orientimi në platforme, futja e të dhënave të raportimit dhe importimi i të dhënave. Zyra për Qeverisje të Mirë bashkë me ekspert të TACSO-s ka krijuar llogaritë për secilin zyrtarë përgjegjës në ministri dhe komuna për qasje në Platformën e Financimeve publike për raportim dhe plotësim të tabelave direkt në platformë.

Në kërkesën për raportim, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit i ka vënë në dijeni udhëheqësit e Organizatave Buxhetore se Rregullorja, mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e

Financimit Publik të OJQ-ve MF-Nr. 04/2017, buron nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, prandaj, mos raportimi ose vonesat në raportim përbën shkelje të Dispozitave të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Zyra për Qeverisje të Mirë ka ofruar gjithë gatishmërinë e saj që të ofrojë ekspertizën e vet dhe ti mbështesë të gjitha organizatat buxhetore që kanë nevojë në përgatitjen e raportit vjetor.

Krahasuar me vitet paraprake, raportimi është përmirësuar dukshëm, megjithatë, ky raport tregon se një numër i konsiderueshëm i institucioneve/organizatave buxhetore nuk kanë dërguar raportin e tyre ose nuk kanë raportuar direkt në platformë sipas kërkesave të rregullores në afatet e parapara tek Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit, apo nuk kanë raportuar nëse Organizata Buxhetore ka financuar ose jo projektet e OJQ-ve në vitin 2021.

Figura në vijim tregon përqindjen dhe numrin e institucioneve/organizatave buxhetore përfshirë Ministrinë dhe Komunat sa i përket raportimit për financim ose jo sipas kërkesave të Rregullores MF-NR-04/2017 për Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve. Sipas Raportit janë rreth 70% e institucioneve që kanë raportuar, (paraqitur në figurë) 46% e institucioneve që kanë raportuar direkt në platformë, 23% kanë raportuar se nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare dhe 31% që nuk kanë raportuar për fondet që janë ndarë për OJQ-të. Pra, nga 57 institucioneve (ZKM katër zyrat, 15 Ministrive dhe 38 komunave) janë: 39 institucione/organizata buxhetore që kanë raportuar dhe 18 që nuk kanë raportuar.




Figura 1. Të dhëna të përgjithshme sa i përket raportimit nga organizatat buxhetore

2.2 Të dhëna mbi raportimin sipas secilës nga Organizatat Buxhetore

Në tabelën në vijim janë paraqitur të dhënat sa i përket secilës organizatë buxhetore të cilës i është kërkuar të raportoj ose ka pasur financim për OJQ-të në vitin 2021. Në rastet kur është paraqitur N/A, organizatës buxhetore nuk i është drejtuar nga Zyra e Kryeministrit kërkesa për raportim, megjithatë, nga të dhënat e Thesarit është vërejtur se organizata e tillë ka pasur financim për OJQ-të gjatë vitit 2021. Disa nga institucionet, kanë theksuar se nuk kanë financuar projekte të OJQ-ve ose nuk kanë shpallur thirrje publike, sidoqoftë, nga të dhënat e Thesarit, ekzistojnë pagesa për furnitor të cilët sipas Thesarit janë paraqitur si OJQ. Duhet pasur parasysh gjithashtu faktin se gjatë vitit 2021 kanë ndodhur riorganizime në strukturën qeveritare, si rezultat i kësaj disa ministri janë bashkuar, ndërsa disa të tjera janë shuar.

Tabela: Të dhënat për financimin publik të OJQ-ve sipas raporteve të përcjella/raportuara nga ana e Institucioneve direkt në platformë, ato që kanë raportuar se nuk kanë ndarë fonde dhe ato që nuk kanë raportuar janë në tabelën në vijim:

NR.	EMRI I ORGANIZATËS BUXHETORE	RAPORTIMI NË ZQM BAZUAR NË RREGULLOREN MF-04/2017
	ZYRA E KRYEMINISTRIT	Agjencia për Barazi Gjinore kanë raportuar direkt në platformë ndërsa Zyra e Komisionerit për Gjuhët, Zyra e Komuniteteve dhe Zyra e Komisionerit për të Zhdukurit në kuadër të ZKM kanë raportuar se gjatë vitit 2021 nuk kanë përkrahur OJQ
MINISTRITË E LINJËS		
1.	MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL	MAPL ka raportuar se nuk financuar projekte të OJQ-ve
2.	MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT	MASHTI kanë raportuar direkt në platformë
3.	MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	Ministria kanë raportuar se gjatë vitit 2021 nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare
4.	MINISTRIA E DREJTËSISË	MD kanë raportuar se gjatë vitit 2021 nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare
5.	MINISTRIA E FINANCAVE PUNËS DHE TRANSFEREVE	MFPT kanë raportuar direkt në platformë
6.	MINISTRIA E MBROJTJES	MM kanë raportuar direkt në platformë
7.	MINISTRIA MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPSIONR DHE INFRASTRUKTURËS	MMPHI kanë raportuar se nuk ndajnë fonde për OJQ-të

8.	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MKRS kanë raportuar direkt në platformë
9.	MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME	MPB kanë raportuar se gjatë vitit 2021 nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare
10.	MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME DHE DIASPORËS	MPJD kanë raportuar direkt në platformë
11.	MINISTRIA E SHËNDETËSISË	MSH kanë raportuar se gjatë vitit 2021 nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare
12.	MINISTRIA E EKONOMISË	ME kanë raportuar direkt në platformë
13.	MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL	MZHR kanë raportuar direkt në platformë
14.	MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM	MKK kanë raportuar se nuk ka pasur financim të OJQ-ve
15.	MINISTRIA E INDUSTRIË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË	MINT kanë raportuar se nuk ka pasur financim të OJQ-ve
KOMUNAT		
1.	KOMUNA E DEÇANIT	Komuna e Deçanit nuk kanë raportuar
2.	KOMUNA E DRAGASHIT	Komuna e Dragashit ka raportuar direkt në platformë
3.	KOMUNA E FERIZAJIT	Komuna e Ferizajt kanë raportuar direkt në platformë
4.	KOMUNA E GJAKOVËS	Komuna e Gjakovës nuk kanë raportuar
5.	KOMUNA E GJILANIT	Komuna e Gjilanit nuk kanë raportuar
6.	KOMUNA E DRENASIT	Komuna e Drenasit kanë raportuar direkt në platformë
7.	KOMUNA E GRAÇANICËS	Komuna e Graçanicës kanë raportuar direkt në platformë
8.	KOMUNA E HANIT TË ELEZIT	Komuna e Hanit të Elezit nuk kanë raportuar
9.	KOMUNA E ISTOGUT	Komuna e Istogut nuk kanë raportuar
10.	KOMUNA E JUNIKUT	Komuna e Junikut nuk kanë raportuar
11.	KOMUNA E KAÇANIKUT	Komuna e Kaçanikut kanë raportuar direkt në platformë
12.	KOMUNA E KAMENICËS	Komuna e Kamenicës kanë raportuar direkt në platformë

13.	KOMUNA E KLINËS	Komuna e Klinës ka raportuar direkt në platformë
14.	KOMUNA E KLLOKOTIT	Komuna e Klokotit ka raportuar direkt në platformë se nuk kanë ndarë fonde në vitin 2021
15.	KOMUNA E LEPOSAVIQIT	Komuna e Leposaviqit nuk kanë raportuar
16.	KOMUNA E LIPJANIT	Komuna e Lipjanit kanë raportuar direkt në platformë
17.	KOMUNA E MALISHEVËS	Komuna e Malishevës nuk kanë raportuar
18.	KOMUNA E MAMUSHËS	Komuna e Mamushës nuk kanë raportuar
19.	KOMUNA E MITROVICËS SË VERIUT	Komuna e Mitrovicës Veriore kanë raportuar direkt në platformë
20.	KOMUNA E MITROVICËS	Komuna e Mitrovicës nuk kanë raportuar
21.	KOMUNA E NOVO BËRDËS	Komuna e Novo Bërdës ka raportuar direkt në platformë
22.	KOMUNA E OBILIQIT	Komuna e Obiliqit kanë raportuar direkt në platformë
23.	KOMUNA E PARTESHIT	Komuna e Parteshit nuk kanë raportuar
24.	KOMUNA E PEJËS	Komuna e Pejës nuk ka dorëzuar raport
25.	KOMUNA E BESIANËS	Komuna e Podujevës nuk kanë dorëzuar raport
26.	KOMUNA E PRISHTINËS	Komuna e Prishtinës kanë raportuar direkt në platformë
27.	KOMUNA E PRIZRENIT	Komuna e Prizrenit kanë raportuar direkt në platformë
28.	KOMUNA E RAHOVECIT	Komuna e Rahovecit kanë raportuar direkt në platformë
29.	KOMUNA E RANILLUGUT	Komuna e Ranillugut nuk kanë raportuar
30.	KOMUNA E SHTËRPECËS	Komuna Shtërpçës kanë raportuar se gjatë vitit 2021 nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare
31.	KOMUNA E SHTIMES	Komuna e Shtimes nuk kanë raportuar
32.	KOMUNA E SKENDERAJT	Komuna e Skenderajt kanë raportuar direkt në platformë
33.	KOMUNA E THERANDËS	Komuna e Suharekës kanë raportuar direkt në platformë
34.	KOMUNA E VITISË	Komuna e Vitisë kanë raportuar direkt në platformë

35.	KOMUNA E VUSHTRRIË	Komuna e Vushtrrisë nuk kanë raportuar
36.	KOMUNA E ZUBIN POTOKUT	Komuna e Zubin Potokut nuk kanë raportuar
37.	KOMUNA E ZVEÇANIT	Komuna e Zveçanit ka raportuar direkt në platformë
38.	KOMUNA E FUSHË KOSOVËS	Komuna e Fushë Kosovës nuk kanë raportuar
INSTITUCIONE TJERA		
1.	ZYRA E PRESIDENTIT	N/A
2.	KUVENDI	N/A
3.	AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT	N/A
4.	AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE	N/A
5.	AKADEMIA E DREJTËSISE	N/A
6.	GJYKATA KUSHTETUESE	N/A
7.	KESHILLI GJYQESOR I KOSOVES	N/A
8.	KESHILLI PROKURORIAL I KOSOVES	N/A
9.	KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE	N/A
10.	KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE	N/A
11.	KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK	N/A
12.	SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITAR I KOSOVËS	N/A
13.	ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT	N/A

3. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR OJQ-TË NË NIVEL TË MINISTRIVE, KOMUNAVE DHE AGJENCIVE TJERA TË PAVARURA

Nga të dhënat e mbledhura dhe të përpunuara mbi financimin publik të OJQ-ve për vitin 2021, mund të konstatojmë se bashkëpunimi me organizatat jo qeveritare në realizimin e prioriteteve të qeverisë në fusha të ndryshme ka vazhduar edhe gjatë vitit 2021. Nga analiza e të dhënave të dorëzuara nga vetë institucionet, gjatë vitit 2021 në nivel të ministrive numri i projekteve për OJQ-të përfituese ka qenë 636, ndërsa në nivel komunal ka qenë 574 pra gjithsej 1211 projekte.

Edhe gjatë vitit 2021 institucionet e nivelit qendror dhe lokal kanë vazhduar mbështetjen e projekteve dhe aktiviteteve të Organizatave jo-qeveritare duke përfshirë financimin e projekteve specifike apo përkrahjes direkte për OJQ-të si dhe nga përkrahja përmes Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

Mbi bazën e të dhënave financiare të siguruara nga Thesari për vitin 2021 rezulton se mbështetja financiare publike për OJQ-të nga institucionet publike përfshirë Kuvendin, Presidencën, Zyrën e Kryeministrit, Ministrinë, Komunitat dhe Agjencitë e Pavarura është rreth 29,768,569.52 Eur.




Figura 2. Të dhëna të përgjithshme sa i përket të dhënave të marra nga Thesari

Prej tyre si projekte kapitale janë dhënë 2,317,197.12 Eur, për bashkësitë fetare 602,005.69 Eur, Asociacionin e Komunave 238,142.21 Eur, Grupet lokale të veprimit 19,398.70 Eur, Federatat dhe klubet sportive 3,859,440.82 Eur, Institucionet tjera përfshirë shërbime të arsimit dhe trajnimit, shërbime sociale dhe të tjera janë rreth 2,644,833.01 Eur.




Figura 3. Të dhëna të përgjithshme sa i përket fondeve të ndara federatave, klubeve, bashkësive fetare, projekteve kapitale dhe të tjera

Ndërsa sipas të dhënave të raportuara në platformën për financim <http://ojqfinancime.rks-gov.net> nga institucionet/organizatat buxhetore të Republikës së Kosovës në vitin 2021 janë ndarë 7,861,439.90 EUR. Sipas këtyre të dhënave Ministritë e linjës kanë ndarë 5,674,984.27 EUR ndërsa niveli lokal kanë ndarë 2,186,455.63 EUR për OSHC-të.

Figura më poshtë pasqyron të dhëna krahasuese për financim publik për vitet 2021-2020 sipas Thesarit. Sipas këtyre të dhënave Zyra e Kryeministrit dhe Ministritë në vitin 2021 kanë ndarë 15,179,248.50 EUR krahasur me vitin 2020 ku kanë ndarë gjithësejt 12,378,332.00 EUR, pra është rritur shuma e fondeve të ndara për OSHC-të. Komunitat gjatë vitit 2021 kanë ndarë 13,838,294.12 EUR, ndërsa në vitin 2020 kanë ndarë 6,954,056.00 EUR, pra edhe komunitat kanë rritur shumën e fondeve të ndara në vitin 2021.

Gjatë vitit 2021 edhe agjencencitë kanë ndarë 469,470.30 EUR ndërsa në vitin 2020 294,075.00 EUR.




Figura 4. Të dhëna krahasuese për financim publik për vitet 2021-2020 sipas Thesarit

Te Figura 4. janë paraqitë të dhënat për financimin publik të OJQ-ve për vitin 2021 nga raporti sipas institucioneve/organizatave buxhetore.




Figura 5. Të dhënat mbi financimin publik të OJQ-ve për vitin 2021 nga raporti sipas institucioneve

Në figurën më poshtë janë paraqitur të dhënat krahasuese për financimin publik të OJQ-ve prej vitit 2019 deri në 2021, pra janë krahasur të dhënat e raportuara nga institucionet publike.




Figura 6. Të dhënat krahasuese për financimin publik të OJQ-ve 2019 deri në 2021

Gjatë vitit 2021 në nivel të ministrive dhe komunave vërehet një ngritje e konsiderueshme në numrin e OJQ-ve përfituese krahasuar me vitin 2020. Në nivel të ministrive gjatë vitit 2020 numri i OJQ-ve ka qenë 420 ndërsa në 2021 është rritur në 1073, ndërsa në nivel të Komunave ka qenë 939 dhe është rritur në 2677.

Të dhënat na paraqesin çdo formë të mbështetjes financiare e cila ka shkuar për furnitorët të cilët në Thesar janë të regjistruar si Organizata Joqeveritare. Ky numër përbën numrin e OJQ-ve që kanë pranuar mjete nga Organizatat Buxhetore. Megjithatë të njëjtat OJQ kanë përfituar mjete nga më shumë se një Organizatë Buxhetore.

Edhe në kuadër të agjencive tjera, të cilat kryesisht i raportojnë Kuvendit, numri i OJQ-të përfituese është rritur nga 43 në 135.

Figura në vijim paraqet në mënyrë krahasuese numrin e përfituesve të mbështetjes financiare publike nga ministritë, komunat dhe agjencitë tjera për vitet 2019-2021 sipas të dhënave të thesarit, ku shihet se kemi rritje të konsiderueshme të përkrahjes së projekteve të OJQ-ve si në nivel qendror ashtu edhe në lokal.




Figura 7. Numri i OJQ-ve që kanë pranuar mjete financiare nga organizatat buxhetore 2019-2021

Qëllimi i mbështetjes financiare të ofruar nga ministrinë dhe komunat

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në përputhje me kërkesat e Rregullores, MF-Nr. 04/2017, dhe rekomandimet e Kuvendit ka iniciuar themelimin e një mekanizmi të përhershëm i cili do të koordinojë punën e planifikimit dhe raportimit vjetor për financimin e organizatave jo-qeveritare në kuadër të secilës ministrie dhe komunë. Në kërkesën për raportim, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit i ka vënë në dijeni udhëheqësit e Organizatave Buxhetore se Rregullorja, mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve MF-Nr. 04/2017, buron nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, prandaj, mos raportimi ose vonesat në raportim përbën shkelje të Dispozitave të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Zyra për Qeverisje të Mirë ka ofruar gjithë gatishmërinë e saj që të ofrojë ekspertizën e vet dhe ti mbështesë të gjitha organizatat buxhetore që kanë nevojë në përgatitjen e raportit vjetor.

Krahasuar me vitet paraprake, raportimi është përmirësuar dukshëm, megjithatë, ky raport tregon se një numër i institucioneve/organizatave buxhetore nuk kanë raportuar direkt në platformë ose përcjell raportin e tyre sipas kërkesave të rregullores në afatet e parapara tek Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit apo nuk kanë raportuar nëse Organizata Buxhetore ka financuar ose jo projektet e OJQ-ve në vitin 2021.

Figura në vijim tregon në përqindje numrin e organizatave buxhetore përfshirë Ministrinë dhe Komunat sa i përket raportimit ose jo, sipas kërkesave të Rregullores MF-NR-04/2017 për Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.




Figura 8. Fushat e financimit të Projekteve të OJQ-ve nga Ministrinë për vitin 2021 në % përqindje të përafërt të financimit

Nga të dhënat e mësipërme mund të shihet se fushat që kanë marrë më së tepërmi financim nga ana e institucioneve të nivelit qendror dhe lokal janë Sporti me 39 % e fondeve, duke përfshirë këtu

Federatat Sportive dhe klubet sportive në mënyrë të drejtpërdrejtë. Krahës kësaj një pjesë e madhe e fondeve gjatë viti 2021 janë ndarë në fushat: art e kulturë me 20,8%, arsim shkencë e hulumtim 16,6%, ekonomi me 9,8% dhe fusha tjera.

Zhvillim i qëndrueshëm, kryesisht janë përfshirë projektet kapitale, ndërtim i shtëpive, bashkëfinancimi i projekteve kapitale me donatorët etj, të cilat janë realizuar në bashkëpunim ose përmes OJQ-ve. Po ashtu, një pjesë e konsiderueshme e mjeteve financiare kanë shkuar për trajnime/edukim, duke përfshirë trajnimet profesionale të ofruara nga OJQ të ndryshme, apo organizata tjera p.sh. trajnime në fushën e kontabilitetit, si dhe trajnimet që kanë të bëjnë me tregun e punës. Gjithashtu një pjesë e mbështetje ka shkuar për OJQ që përfaqësojnë shoqatat e kategorive të dala nga lufta.

Zyra për Qeverisje të Mirë me qëllim të informimit të publikut ka analizuar të dhënat e të raportuara por edhe të dhënat nga të gjitha pagesat e kryera nga ana e këtyre institucioneve dhe mbi bazën e atyre të dhënave bazike në dispozicion mund të konstatoj se shumica e Ministrive kanë mbështetur OJQ-të në fushën e tyre të përgjegjësisë dhe prioriteteve.

Duke marrë parasysh që mbi bazën e të dhënave në dispozicion, është e vështirë të bëhet një dallim në mes të projekteve dhe programeve të financuara dhe përkrahjes direkte apo kontraktimit për ofrimin e shërbimeve apo blerjes së nga ana e OJQ-ve, në kuadër të këtyre të dhënave janë të përfshira edhe shërbimet e kontraktuara, duke përfshirë shërbimet e edukimit, trajnimit etj, të ofruara nga organizatat e regjistruara si organizata jo-qeveritare. Për shembull shumë nga institucionet qendrore kanë paguar për shërbimet që janë paguar për trajnim si Universitetit Amerikan në Kosovë, i cili është i regjistruar si organizatë jo qeveritare. Po ashtu, trajnimet në fushën e kontabilitetit dhe auditimit janë të përfshira pasi që organizatat që i kanë ofruar të njëjtat janë regjistruar si organizata jo-qeveritare.

4. TË DHËNA PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR OJQ-TË SIPAS MINISTRIVE, KOMUNAVE DHE AGJENCIVE TJERA

4.1 Të dhënat e përgjithshme për Financimin Publik të OJQ-ve për vitin 2021 sipas raportimit nga Institucionet Publike/Organizatave buxhetore

Në tabelën në vijim janë të përfshira raportet/të dhënat sipas Ministrive të Linjës dhe Komunave. Shuma përfshinë të gjitha pagesat e kryera gjatë vitit fiskal nga data 1 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2021. Këto të dhëna janë të ndërlidhura me pagesat, të paraqitura në anekset e këtij raporti, që përfshijnë listën e përfituesve.

NR.	EMRI I ORGANIZATËS BUXHETORE	Shuma e dhënë nga institucionet te OJQ gjatë vitit 2021 (Euro)
	<u>ZKM dhe Ministritë</u>	
1.	Zyra e Kryeministrit	684,500.00
2.	Ministria e Kultures Rinise dhe Sportit	3,315,396.95
3.	Ministria e Mbrojtjes	298,011.00
4.	Ministria e Financave, Punes dhe Transfereve	997,000.00
5.	Ministria e Ekonomise	4,146.55
6.	Ministria e Arsimit, Shkences, Teknologjise dhe Inovacionit	255,099.77
7.	Ministira e Zhvillimit Rajonal	103,995.00
8.	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	10,840.00
	<u>KOMUNAT</u>	
9.	Komuna Dragash	40,295.00
10.	Komuna Ferizaj	115,550.00
11.	Komuna Drenas	132,208.85
12.	Komuna Gracanice	177,317.00
13.	Komuna Kacanik	50,500.00
14.	Komuna Kamenice	109,092.75
15.	Komuna Kline	153,230.00
16.	Komuna Lipjan	102,675.00
17.	Komuna Mitrovica Veriore	70,460.00
18.	Komuna Artanë	3,000.00
19.	Komuna Obiliq	81,274.70
20.	Komuna Prishtinë	398,562.21
21.	Komuna Prizren	416,680.12
22.	Komuna Rahovec	130,000.00
23.	Komuna Skenderaj	104,200.00
24.	Komuna Therandë	33,400.00
25.	Komuna Viti	38,000.00
26.	Komuna Zvecan	3,500.00

Në tabelën në vijim janë të përfshira raportet sipas ministrive të Linjës dhe Komunave të cilat kanë raportuar se nuk kanë ndarë fonde.

NR.	Emri i Institucionit	Kanë raportuar që gjatë vitit 2021 nuk kanë ndarë fonde për OSHC-të
	ZKM dhe Ministrinë	
27.	ZKM/ Zyra për Komunitet/ Zyra e Komisionerit për gjuhët dhe Zyra e Komisionerit për të zhdukurit	Nuk kanë ndarë fonde
28.	MAPL –Ministria e Administritimit të Pushtetit Lokal	Nuk kanë ndarë fonde
29.	MBPZHR –Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	Nuk kanë ndarë fonde
30.	MD-Ministria e Drejtësisë	Nuk kanë ndarë fonde
31.	MMPHI - MINISTRIA MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPSIONR DHE INFRASTRUKTURËS	Nuk kanë ndarë fonde
32.	MPB –Ministria e Punëve të Brendëshme	Nuk kanë ndarë fonde
33.	MSH –Ministria e Shëndetësisë	Nuk kanë ndarë fonde
34.	MKK- Ministria për Komunitetet dhe Kthim	Nuk kanë ndarë fonde
35.	MINT –Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	Nuk kanë ndarë fonde

	KOMUNAT	
36.	KOMUNA E KLLOKOTIT	Nuk kanë ndarë fonde
37.	KOMUNA E SHTËRPCËS	Nuk kanë ndarë fonde

4.2 Mbështetja Financiare për OJQ-të në kuadër të MINISTRIVE për vitin 2021

Sipas raporteve që i kemi pranuar nga institucionet në vitin 2021 vërehet një rënje e theksuar e financimit të OJQ-ve. Të dhënat e paraqitura në vijim tregojnë shumën e mbështetjes financiare publike për OJQ-të sipas raporteve të pranuar nga ministrinë përkatëse e cila është dhënë në vitin

2021 dhe e njëjta është krahasuar edhe me vitin paraprak 2020(ku të dhënat në figurë janë sipas Thesarit).

Nëse i analizojmë të dhënat e mbështetjes financiare publike, mund të konstatojmë se sa i përket shumës së mbështetjes financiare, institucionet që më së shumti kanë përkrahur projektet e OJQ-ve janë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Minsitria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Zyra e Kryeministrit.

